



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.04.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1.Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për raportin e veprimtarisë vjetore të AMA-s për vitin 2018.

2.Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për raportin e veprimtarisë vjetore të RTSH –së për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Mirela Kumbaro.

Mungojnë:

Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Enada Kapllani.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi - Mirëmëngjesi!

Besoj se e kemi kuorumin për të filluar mbledhjen, kështu që t'u themi edhe medieve të futen brenda.

Siç kemi rënë dakord dje, sot kemi për t'u njohur me rezolutat që u plotësuan edhe me shënimet tona të djeshme, pas dëgjësës që bëmë me RTSH-në dhe të kuptuarit e disa çështjeve që lidhen edhe me AMA-n. Grupi i ekspertëve që vijnë nga Shërbimi i Monitorimit punoi për t'i realizuar të dyja këto draftrezoluta në bashkëpunim me kolegun Ulqini. Sot jemi mbledhur për të diskutuar variantin final dhe për t'i miratuar të dyja rezolutat, si të AMA-s, ashtu edhe të RTSH-së. Të mos harrojmë që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit rezoluta e AMA-s është në rendin e ditës.

Zoti Ulqini fjala është për ju, nëse doni të shtoni gjëra, me të cilat duhet të njihet komisioni.

Musa Ulqini - Faleminderit, zonja kryetare!

Pika e parë është projektrezoluta për AMA-n, e cila është hartuar mbi bazën e të gjitha kritereve dhe vendimit që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë në dhjetorin e vitit të kaluar. Janë marrë në konsideratë gjëra që thuhet në raport, ato që u thanë këtu nga diskutimet tona, si dhe është pasuruar edhe me disa elemente të reja.

Propozoj të shtohen edhe 2-3 gjëra te projekti në fjalë. Po i lexoj dhe nëse biem dakord, mund t'i shtojmë. Bëhet fjalë për pjesën e tretë: "Detyrat për të ardhmen". Mendoj të shtohet propozimi, si pikë më vete: "Shtimi dhe intensifikimi i tryezave tematike, dëgjësive me grupet e ndryshme të interesit për përmbajtjen e Kodit të Transmetimit, sensibilizim për ta respektuar atë, si dhe për tema që rrjedhin nga zhvillime të ndryshme teknologjike dhe mediatike, sinergji midis këtij institucioni dhe organizatave qeveritare "Në mbrojtje të fëmijëve" dhe nënkomisionit parlamentar "Miqte e fëmijëve"". Kjo është një pikë, që mendoj të shtohet për shkak se Kodi i Transmetimit është instrumenti kryesor i AMA-s dhe të gjithë transmetuesit duhet ta marrin në konsideratë. Duke e futur si pikë, ne i japim një fuqi detyruese më të madhe institucionit që të punojë dhe ajo çfarë thuhet te ky kod, të realizohet duke pasur parasysh mbrojtjen e fëmijëve, duke e bërë pjesë edhe nënkomisionin parlamentar "Miqte e fëmijëve".

Pika e dytë është ndjekja në vijim deri në zbatimin e tij të plotë të detyrimeve ligjore të operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave. Edhe kjo mendoj se është një gjë e rëndësishme. Transmetuesit kombëtarë duhet ta aplikojnë këtë standard që është i BE-së, i kërkuar edhe nga EBU-ja për transmetuesin publik.

E treta, vijimin e punës për hartimin dhe miratimin e kuadrit të nevojshëm nënligjor, përmes miratimit të akteve të reja rregullatore, hartimin e ndryshimeve apo shtesave në aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo buron edhe nga ajo çfarë ne kemi miratuar si Kuvend në dhjetorin e vitit të kaluar.

E fundit, konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucionet analoge të Kosovës dhe me vendet shqipfolëse. Është fjala për Maqedoninë, Malin e Zi, pra, ku ka shqiptarë, në mënyrë që AMA të bashkëpunojë me këto institucione.

Këto janë 4 sugjerimet që kam. Në gjykimin tim rezoluta i plotëson të gjitha kriteret ligjore, standardet dhe mënyrën se si duhet të hartohen këto dokumente. Është një dokument që ne kemi mundësi ta monitorojmë, por jep sinergji, fuqi, angazhim edhe për institucionet në fjalë. Sugjeroj, si relator, që projektrezoluta të miratohet me këto 4 pika.

Milva Ekonomi – Kolegë, a keni ndonjë pyetje?

Ne e kemi parë draftrezolutën e AMA-s dhe në mbledhjen e shkuar. Pas dëgjësës që bëmë dje me RTSH-në, u punua për ta përfunduar projektrezolutën. Dëgjuam komentet që propozoi zoti Ulqini, pikat që do të shtohen në draftin e projektrezolutës. Jeni dakord me sugjerimet e zotit Ulqini? Dakord.

Para se të kalojmë te çështja tjetër, unë do të bëja edhe dy kërkesa për miratim. Jeni dakord që të miratojmë draftrezolutën e plotë në bazë të sugjerimeve? Jeni dakord që të miratojmë raportin vjetor të AMA-s për vitin 2018? Dakord.

Projektrezoluta e AMA-s për vitin 2019 është e gatshme për të kaluar në seancën e Kuvendit të ditës së enjte.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.04.2018, ora 10:15

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për raportin e veprimtarisë vjetore të RTSH –së për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Mirela Kumbaro.

Mungojnë:

Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Enada Kapllani.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Kalojmë te rezoluta për RTSH-në. Ne e kemi diskutuar dje dhe kemi pasur diskutime edhe për përmirësimin e saj. Shërbimi i Monitorimit ka reflektuar kërkesat tona.

Zoti Ulqini, do t'ju lutesha të thoni disa fjalë edhe për rezolutën e RTSH-së.

Musa Ulqini - Rezoluta që kemi përpara plotëson kriteret, ashtu si rezoluta e AMA-s. E rëndësishme është që në një kohë të shkurtër Shërbimi i Monitorimit ka reflektuar të gjithë diskutimin tonë, që u bë dje për raportin vjetor të RTSH-së. Pra, janë pasqyruar, sidomos te pjesa e tretë, që ka të bëjë me angazhimet, me atë çfarë kërkojmë ne nga Këshilli Drejtues i RTSH-së për vitin 2019, sugjerimet thelbësore që u bënë nga diskutantët, nga të gjithë kolegët deputetë. Ju ftoj ta votojmë projektrezolutën.

Në fund, dua të falënderoj të dy ekspertët, specialistët e Shërbimit të Monitorimit, pasi ky është produkt i të gjithë diskutimeve tona, por i formalizuar në një mënyrë krejt korrekte, në përputhje me të gjitha rregullat! Ata e meritojnë një falënderim. Besoj se kemi bërë një punë të mirë.

Milva Ekonomi – Keni për të shtuar diçka?

Fadil Nasufi - Falënderoj ekspertët dhe relatorin zotin Ulqini, sepse është bërë një dokument shumë cilësor dhe ka marrë në konsideratë të gjitha problematikat që diskutuam mbi bazën e raportit. Ndoshta mund të jetë e tepërt, por po bëj një propozim dhe ta gjykojmë si komision. Nisur nga projekti ambicioz i “100 fshatrave” dhe nga fakti se janë rreth 4000 fshatra në Shqipëri që përballen me probleme të shumta dhe sfidat e zhvillimit bujqësor, rural, të ketë një cikël telereportazhesh dhe emisionesh të dedikuara për këtë qëllim. Po bëj një propozim. Nuk e di nëse futemi në kaq detaje apo ngelemi në konceptin e përgjithshëm.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Jam dakord me projektrezolutën dhe me propozimet që janë bërë, por doja të shtoja këtë propozim, meqenëse u ngri edhe gjatë diskutimit të djeshëm, nga diskutimet tona, nga pyetjet, nga sqarimet dhe nga shqetësimet që vetë drejtuesit e RTSH-së na i shprehën lidhur me realizimin e të ardhurave financiare.

Ata kërkojnë edhe ndihmën dhe mbështetjen e këtij komisioni dhe unë mendoj të pasqyrohet si detyrim në projektrezolutë.

Konkretisht, propozoj që Këshilli Drejtues i RTSH-së dhe RTSH-ja të nënshkruajnë një marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunim me AMA-n, OSHEE-në, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e tjera në varësi për transferimin e detyrimeve financiare nga tarifa e aparatit televiziv, si dhe nga shërbimet ndaj të tretëve, sidomos operatorëve privatë, në mënyrë që veprimtarinë e këtij institucioni mos ta fusim në ngërç. Ata kanë benefite ekonomike, se ua jep ligji dhe nuk i marrin dot.

Milva Ekonomi - Urdhëroni, zoti Ulqini!

Musa Ulqini – Në lidhje me sugjerimin e pare, mendoj se është shumë i drejtë dhe kjo ishte edhe pjesë e diskutimit tim. Në mënyrë të posaçme, është një pikë këtu që e konsideron këtë gjë, me mënyrën se si duhet formuluar dhe të thuhet: “Të përmbushen detyrimet e parashikuara në kontratën e shërbimit të transmetimit publik për fillimin e transmetimeve të kanaleve dhe programeve të reja, të cilat në raportin vjetor të AMA-s rezultojnë si detyrime të papërmbushura”.

Ka një kontratë mes AMA-s dhe RTSH-së dhe pjesë e kësaj kontrate është edhe një kanal, që është quajtur “RTSH-Jetë”, por në fakt është bërë një ndryshim dhe quhet “RTSH-Agro”. Këtu u dhanë shpjegime dhe kjo pikë e realizon 100% kërkesën tuaj, sepse fjala është për një kanal 24-orësh, që trajton problemet e bujqësisë, problemet e fermerëve, problemet e fshatit.

Në qoftë se sot RTSH-ja transmeton një herë në javë në një program të posaçëm jetën e fermerëve, propozimi në kontratën e shërbimit propozon që të ketë një kanal 24- orësh dedikuar zonave rurale.

Kjo pikë, siç është formuluar, e plotëson në mënyrë të plotë kërkesën tuaj.

A biem dakord bashkë për këtë çështje?

Bëra një shpjegim të nevojshëm, sepse jemi në një mendje dhe kjo gjë e plotëson këtë.

Milva Ekonomi – Dua të shtoj edhe diçka tjetër. Ne dje vendosëm që mbase do të bënim një takim me bordin drejtues pikërisht për programacionet, sidomos ato me fokus bujqësinë, kulturën dhe librin.

Musa Ulqini – Ndërkohë, për shqetësimin që ishte pjesë e diskutimeve dje, për çështjet që lidhen me anën financiare, po ta shikoni, të dyja rezolutat ndryshojnë vetëm në një gjë. Rezoluta për Këshillin Drejtues të RTSH-së në fund ka edhe një çështje me *bold*: “Kuvendi i kërkon qeverisë që për vitin 2019 e në vijim...”, shprehje e cila nuk ka qenë në rezolutat e tjera.

Brenda kësaj shprehjeje është i përfshirë shqetësimi që shprehën drejtuesit ekzekutivë të RTSH-së, drejtuesit e Këshillit Drejtues dhe ne që ishim këtu me diskutimet tona. Këtu thuhet që të ketë në vëmendje zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së, duke siguruar mbështetjen e domosdoshme financiare, që garanton autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale, si dhe merr përsipër financimin e domosdoshëm për të bërë të mundur kryerjen e shërbimeve në fushën e medieve audiovizive nga RTSH-ja.

Pra, ky formulim i ka brenda të gjitha gjërat konkrete që ne duhet t’i bëjmë, sepse kështu janë rezolutat. Është në natyrën e rezolutave dhe kërkoj mirëkuptimin e zotit Ismet.

Kjo është bërë në mënyrë specifike, është një gjë që nuk ka qenë në rezolutat e tjera të RTSH-së, nuk është as të rezoluta e AMA-s dhe mbi bazën e kësaj marrin spunto disa gjëra që ne duhet të bëjmë si komision, që lidhen me OSHEE-në, me Ministrinë e Financave, me AMA-n, si dhe me operatorët lokalë.

Milva Ekonomi – Si anëtarë të këtij komisioni e dimë që fuqia për të marrë vendime që kanë efekt financiar, nuk i takon komisionit. Komisioni harton një shkresë për nismën që merr dhe ia kalon për mendim Ministrisë së Financave. Pa u përgjigjur Ministria e Financave, komisioni nuk ka të drejtë të veprojë për të lehtësuar apo vështirësuar veprimet.

Në këtë rast unë personalisht mendoj se ky formulim që kemi bërë në projektrezolutë shkon përshtat edhe me kërkesën që ka zoti Ismet, por që do të marrë kohën e vet për ta parë se si do të zbatohet, se mund të jetë edhe amendim i ligjit të Buxheti organik ose edhe amendimi i ligjit të Buxhetit për këtë vit, që mund të ketë nevojë për këto ndryshime. Ne nuk dimë të shprehemi tani për tani.

Musa Ulqini – Prandaj është formuluar kështu “Kuvendi i kërkon qeverisë”, nuk thuhet “komisioni”, sepse komisioni është një diçka parciale. Në këtë rast është institucioni i Kuvendit që i kërkon qeverisë dhe pjesë e qeverisë është Ministria e Financave.

Pra, ne i kemi dhënë një fuqi shumë të madhe çështjes, duke e ngritur në një stad shumë të lartë, duke thënë se Kuvendi i kërkon qeverisë.

Ismet Beqiraj – Unë kam një qasje tjetër për këtë punë, për ta bërë më të thjeshtë dhe më konkrete. Dakord jam, por Kuvendi gjithmonë i kërkon qeverisë dhe kësaj i thonë të kapësh veshin e majtë me dorën e djathtë dhe anasjelltas. Ne këtu po miratojmë projektrezolutë, nuk po miratojmë Kushtetutën. Pse duhet të vijmë vërdallë drejtuesit e RTSH-së, duke qenë se është një detyrim kushtetues dhe ligjor që tarifa e aparateve të transmetimeve televizive t’i marrë RTSH-ja?!

Jam plotësisht dakord me atë çka është shkruar aty, por ama pa para, pa buxhet nuk bën dot, edhe kur i ke këto shërbime. Ndaj të futet si pikë në mënyrë eksplicite, që cilido ta ndiejë si detyrim, edhe AMA ta ndiejë si detyrim që t’i vjelë, edhe OSHEE-ja, edhe Ministria e Financave ta ndiejë si detyrim, dhe jo vetëm kur të ketë kontroll parlamentar, që t’i thërrasim ne ata. Po, le të bëjnë një memorandum, një marrëveshje bashkëpunimi, nuk ka asnjë gjë të keqe. Unë nuk tërhiqem nga ky propozim.

Milva Ekonomi- Ne bëjmë kërkesën, që të futet në rezolutë. A kemi bërë ndonjë diskutim me OSHEE-në pse është vendosur ky 10%, pse nuk u vendos 7% apo 6%? Ne nuk

e dimë në këtë çast arsyen pse është vendosur kjo normë, nuk është detyra jonë që të imponohemi për këtë pjesë.

Ismet Beqiraj – Si duket ata e kishin shqetësim, sepse nuk ulen të bëjnë transparencën.

Milva Ekonomi – Nuk e bëjnë ata.

Ismet Beqiraj – Kush do ta bëjë?!

Milva Ekonomi – I kalon automatikisht thesarit, fitova kaq para nga taksa dhe kaq do të të kalojnë ty. Në këtë që të vjen ty, 10% i mbaj unë.

Ismet Beqiraj – Çfarë të keqe ka që këto institucione, për të përmirësuar bashkëpunimin, të bëjnë një marrëveshje mirëkuptimi, sepse nuk e kuptoj ku është shqetësimi?! Kë rrezikon kjo nga këto institucione: RTSH-në, që kërkon ndihmë apo OSHEE-në që nuk bën detyrën?!

Milva Ekonomi – Ne nuk e dimë se cila nuk e bën detyrën, sepse nuk jemi ne për të gjykuar këtë punë

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më duhet ta sqaroj, se ky është një udhëzim i përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe RTSH-së, dhe nuk është në tagrin tonë ligjor të bëjmë këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërkohë, mund të ndërmarrësh një nismë për të ndryshuar ligjin “Për taksat vendore” dhe është e mirëpritur, por nuk mund të presë rezoluta ndryshimet që mund t’i bëjmë ne ligjit “Për taksat vendore”. Besoj se në këtë çast kjo nuk mund të jetë pjesë e rezolutës. Ndërkohë, qëllimin e mirë e kemi te formulimi i kësaj pjese, por duhet ta shikojmë nga pikëpamja e fjalëve, pra si do t’i përmirësojmë fjalët. Ne këtu themi: “Të ketë në vëmendje zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së për të siguruar mbështetjen e domosdoshme financiare, që garanton autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale”, si dhe “Kuvendi merr përsipër financimin e domosdoshëm...”, pra “synon”, sepse nuk mund ta marrim ne përsipër. Me ndryshimin “synon”, a mund ta kalojmë, sepse nuk mund të vendosim ne detyrime?!

Musa Ulqini – Duke qenë dakord me shqetësimin e zotit Ismet ne, si komision, në zbatim të këtij detyrimi që Kuvendi e voton dhe e kthen në një detyrë, do të bëjmë një mbledhje vetëm për këtë çështje dhe do të vendosim një plan pune se kush duhet të bëjë çfarë. Pra, diku sugjerojmë, diku kërkojmë, diku urdhërojmë sipas kompetencave që kemi, duke angazhuar edhe Kuvendin. Mendoj se me këtë ndryshim që bëmë, është e saktë, sepse

kjo është natyra e rezolutave. Rezolutat janë të shkurtëra. Unë jam luftëtar i madh i kësaj gjëje dhe e mirëkuptoj, por kjo gjë, që është bërë për herë të parë, ku Kuvendi angazhohet dhe i kërkon qeverisë, kjo fjali duket e përgjithshme, por rezolutat këtë natyrë kanë. Pra, jemi ne që do ta konkretizojmë. I gjithë shqetësimi nuk ka lidhje me OSHEE-në, por ky është një detyrim shumë i madh; nuk është vetëm OSHEE-ja, ka edhe gjëra të tjera. Pra, është një koncept kaq i gjerë, kështu siç është formuluar, që na jep mundësinë, që të bëjmë edhe më shumë punë të mira për RTSH-në sesa 2-3 gjëra që i diskutuam dje.

Milva Ekonomi – Atëherë, me këto ndryshime në formulimin e paragrafit të fundit, në vend të fjalës “merr përsipër”, vendoset fjala “synon”, a jeni dakord të miratojmë projektrezolutën? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Të ketë vëmendje në zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së për të siguruar mbështetjen e domosdoshme financiare për të garantuar autonominë institucionale, pavarësinë editoriale, si dhe synon financimin e domosdoshëm për të bërë të mundur kryerjen e shërbimit publik në fushën e medieeve audiovizive”.

Pas këtyre dy miratimeve, duhet të kemi parasysh që nga zbardhja e procesverbaleve, të nxjerrim edhe disa detyra që kemi marrë përsipër gjatë diskutimeve për raportet e veprimtarisë 1-vjeçare të AMA-s dhe RTSH-së. Për shembull, kemi marrë përsipër të çojmë përpara kontratën tip për gazetarët; kemi marrë përsipër që të bëjmë një mbledhje tripalëshe midis AMA-s, RTSH-së dhe transmetuesve lokalë; kemi marrë përsipër një takim me Këshillin Drejtues; siç kemi propozimin që vjen nga zoti Ismet për të parë mundësinë, në qoftë se ullet tarifa 10% e OSHEE-së. Pra, të gjitha këto mendoj që sekretaria të na i vendosë në kalendarin e veprimtarisë së komisionit dhe të kemi parasysh që gjatë muajve maj-qershor duhet të vazhdojmë të punojmë me këto orientime që kanë dy rezolutat. A jeni dakord që t'i përfshijmë si aktivitete tonat? Në rregull.

Gjithashtu, mund të na kërkohet që të enjten të kemi edhe folës për rezolutën. A ka dëshirë ndonjëri nga ju që të flasë? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se do të kërkohet për të folur, do të flasë vetëm relatori.

Musa Ulqini – Sipas Rregullores, në qoftë se duhet që të flasë dikush, duhet ta kërkojë kryetari i grupit, pra janë disa procedura për të folur atje. Ne, si komision, biem dakord dhe kemi bërë të gjitha diskutimet. Në praktikën e krijuar, ne propozojmë që nuk ka për...

Milva Ekonomi –Të enjten në mëngjes kemi një takim për të vendosur për diskutantët dhe në këtë rast them se komisioni do të bjerë dakord që për këtë çështje të flasë zoti Ulqini.

Unë mendoj se nuk kemi çështje të tjera për të diskutuar sot, sepse i miratuar draftrezolutat, bëmë gati një kalendar veprimesh për muajin maj dhe qershor, nisur nga dy diskutimet e raporteve të veprimtarisë për vitin 2018 të dy institucioneve dhe për nesër kemi caktuar një relator. A jeni dakord me konkluzionet e mbledhjes?

Dakord.

MBYLLET MBLEDHJA